



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI I PRIVATIZIMIT**

Nr. 3035 Prot.

Ballsh, më 18.06. 2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. 27, Datë 18.06. 2026

PËR

**MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT TË PASURISË LLOJI APARTAMENT ME NR.
3/70+1-16, ZK 1090, PËRFITUAR NGA QYTETARI SHPËTIM MUHAMET
ALUSHI ME VENDIM TË KOMISIONIT TË STREHIMIT, K.P.TH.N, LGJ. "18
PRILLI", BALLSH, MALLAKASTËR**

- KËSHILLIT TË BASHKISË

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", ndryshuar, , urdhërit nr.331 datë 24.10.2025, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër "Për ngritjen e komisionit për vazhdimin e procedurave për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara në territorin e Bashkisë Mallakastër", të Vendimit nr. 42, datë 21.11.2025, "Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me nr. 3/70+1-16, apartament, ZK 1090, lagjja "18 Prilli", Ballsh, Bashkia Mallakastër", të Këshillit të Bashkisë Mallakastër, të urdhrit nr. 399, datë 09.12.2025 "Për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Mallakastër datë 21.11.2025", të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, si dhe referuar kërkesës nr. 740 prot., datë 12.02.2026 "Kërkesë për privatizimin e banesës", të znj. Bamira Ahmet Alushi, përfaqësuar me prokurë të posacme nr. 672 rep. nr. 287 kol, datë 14.10.2020, nga Z. Seit Kulloraj,

PROPOZOJ:

1. Privatizimin e pasurisë të llojit apartament me nr. nr. 3/70+1-16, ZK 1090, përfituar nga qytetari Shpëtim Muhamet Alushi, me vendim të Komisionit të Strehimit, K.P.TH.N, lgj. "18 Prilli", Ballsh, Mallakastër".
2. Pergatitja e dosjes së privatizimit për kalimin e pronësisë, si dhe pagesa e vlerës së privatizimit do të kryhet në bazë të VKM-në nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321,

datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”, ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në bazë të pikës 6, të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar.

Komisioni i Privatizimit

Rovena Osmenaj

Aleksandër Rama

Besjana Velaj

Aurora Heqimaj

Rexhep Likaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI I PRIVATIZIMIT

Nr. 30354/Prot.

Ballsh, më 18. 06 2026

RELACION PËR PRIVATIZIMIN TË PASURISË LLOJI APARTAMENT ME NR. 3/70+1-16, ZK 1090, PËRFITUAR NGA QYTETARI SHPËTIM MUHAMET ALUSHI ME VENDIM TË KOMISIONIT TË STREHIMIT, K.P.TH.N, LGJ. "18 PRILLI", BALLSH, MALLAKASTËR"

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM nr. 179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore", ndryshuar, të Vendimit nr. 42, datë 21.11.2025, "Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me nr. 3/70+1-16, apartament, ZK 1090, lagja "18 Prilli", Ballsh, Bashkia Mallakastër", të Këshillit të Bashkisë Mallakastër, të urdhrit nr. 399, datë 09.12.2025 "Për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Mallakastër datë 21.11.2025", të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër, urdhërit nr. 331 datë 24.10.2025, të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër "Për ngritjen e komisionit për vazhdimin e procedurave për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara në territorin e Bashkisë Mallakastër", si dhe referuar kërkesës nr. 740 prot., datë 12.02.2026 "Kërkesë për privatizimin e banesës", të znj. Bamira Ahmet Alushi, përfaqësuar me prokurë të posacme nr. 672 rep. nr. 287 kol, datë 14.10.2020, nga Z. Seit Kullorja, komisioni i privatizimit i përbërë nga Znj. Rovenja Osmenaj, Përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse, Z. Aleksandër Rama, Drejtor i drejtorisë Ekonomike dhe i Çështjeve Social, Znj. Besjana Velaj, përgjegjëse e planifikimit, projektimit, Znj. Aurora Heqimaj, specialist jurist, Z. Rexhep Likaj, specialist topograf, si njësi përgjegjëse për privatizimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, bazuar dokumentacionin e administruar ndër vite pranë Bashkisë Mallakastër, si dhe të dokumentacionit të depozituar nga ana e Z. Seit Kulloraj, propozon privatizimin pasurisë lloji apartament me nr. 3/70+1-16, ZK 1090, përfutur nga qytetari Shpëtim Muhamet Alushi, me vendim të Komisionit të Strehimit, K.P.TH.N, lgj. "18 Prilli", Ballsh, Mallakastër".

Dokumentacioni i dorëzuar nga ana e Z. Seit Kulloraj:

- Kërkesë nr. 740 prot., datë 12.02.2026
- Prokurë të posacme nr. 672 rep. nr. 287 kol, datë 14.10.2020
- Fotokopje ID
- Vendim për strehim viti 1994, të Komisionit të Strehimit, K.P.TH.N, lgj. "18 Prilli", Ballsh, Mallakastër.

- Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. rep 504, nr. kroleksioni 276, datë 16.03.2026
- Certifikatë familjare aktuale
- Certifikatë familjare e datës 01.12.2004
- Certifikatë familjare e datës 01.12.1992
- Planimetria e dhomave të përfituara
- Licenca e projektuesit

Sipas vendimit të vitit 1994 të Komisionit të Strehimit pranë K.P.TH.N, lgj. “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër, Z. Shpëtim Alushi ka përfitur për strehim një apartament me sipërfaqe totale prej 68.36 m², që përputhen me pasurinë me nr. 3/70+1-16, ZK 1090, përfitur nga qytetari Shpëtim Muhamet Alushi me vendim të Komisionit të Strehimit, K.P.TH.N, lgj. “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër.

Pergatitja e dosjes së privatizimit për kalimin e pronësisë, si dhe pagesa e vlerës së privatizimit do të kryhet në bazë të VKM-në nr. 179, datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe te objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe te ndërmarrjeve shtetërore”, ndryshuar.

KOMISIONI I PRIVATIZIMIT

Rovena Osmenaj

Besjana Velaj

Rexhep Likaj

Aleksandër Rama

Aurora Heqimaj